



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

KESHILLI BASHKIAK

Nr Prot 937/6

Pogradec, më 17.06.2025

Njoftim për konsultim publik

Mbledhja e rekomandimeve për Tavanet Përgatitore Buxhetore 2026-2028 dhe për Draftin e parë të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2026 – 2028.

Propozuesi i akteve: Kryetari i Bashkisë, z. Ilir Xhakolli.

- 1. Sqarime për projekt-aktin:** Konsultimi publik synon të identifikojë mendimin e komunitetit për shpenzimet e parashikuara në lidhje me programet/shërbimet që ofron bashkia referuar Tavanëve përgatitore buxhetore të parashikuara për 2026-2028, si dhe të marrë rekomandimet e publikut në lidhje me draftin e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të bashkisë Pogradec.
- 2. Kalendari i konsultimit:** *Aktivitetet organizohen sipas kalendarit të konsultimit publik bashkangjitur këtij njoftimi*

Banorët do të kenë mundësi të konsultojnë dokumentat në lidhje me çështjet për diskutim në link-et e mëposhtëm.

Tavanet përgatitore buxhetore 2026-2028

<https://bashkiapogradec.gov.al/ngarkime/njoftimet/docs/vend-nr-24-dt-27-03-2025.pdf>

PBA (drafti i parë) 2026-2028

[130620250747--pba-2026-2028-pogradec-.pdf](https://bashkiapogradec.gov.al/ngarkime/njoftimet/docs/130620250747--pba-2026-2028-pogradec-.pdf)

Pjesëmarrës nga ana e Këshillit Bashkiak dhe e Ekzekutivit:

- Anëtarët e Këshillit Bashkiak,
- Përfaqësues nga ekzekutivi,
- Anëtarët e Komisionit të Ekonomisë dhe Financës të Këshillit të Bashkisë Pogradec,
- Kryetarja e Aleancës së Grave Këshilltare
- Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik,

-Zyra e Financës së Bashkisë

- Grupe interesi nga shtresa vulnerable

- Perfagesues te Shoqerise civile

Format e konsultimit :

- **Konsultim me takime fizike.**
- **Vjelje mendimi nëpërmjet postës dhe postës elektronike.**

Qëllimi i këshillimit publik	Evdientimi i nevojave dhe i mendimit të komunitetit përkundrejt programeve/shërbimeve që ofron bashkia, si dhe marrja e rekomandimeve të publikut ne lidhje me planifikimin dhe shpenzimet e parashikuara në Tavanet Përgatitore Buxhetore 2026-2028 dhe draftin e parë të Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028 të bashkisë Pogradec
Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti	Miratimi i Tavanëve Përgatitore Buxhetore dhe Projekt Buxhetit Afatmesëm është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike të shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetareve: <ul style="list-style-type: none">• Për mënyrën se si duhet të shpërndahen fondet përgjatë 2026-2028• Për nivelin e financimit të parashikuar në Tavanet Përgatitore buxhetore 2026-2028• Sa dhe si fondet e planifikuara për 2026-2028 shërbejnë për të përmirësuar shërbimet që ofron bashkia• Për cilat shërbime / funksione, komuniteti mendon se bashkia duhet të shpenzojë më shumë gjatë tre viteve të ardhshme.
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon : <ol style="list-style-type: none">1. A jeni dakort me mënyrën si janë planifikuar të shpenzohen paratë?2. Cilat janë nevojat tuaja, për përmbushjen e të cilave duhen përmirësuar shërbimet që ofrohen nga ana e Bashkisë?3. Cilat janë shërbimet prioritare për të cilat bashkia duhet të shpenzojë më shumë fonde publike gjatë periudhës 2026 – 2028?4. Për cilin shërbim publik jeni më të kënaqur? <p>Tjetër</p>
	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat

<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pergatitjen nga ana e Sekretariatit të Këshillit të një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit/takimeve që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje. 2. Dërgimi i Përmbledhjes me Rekomandimet Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës... dhe këshilltarëve të KB. 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe finances... (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë në lidhje me to; 4. Reflektimi i rekomandimeve të dala nga konsultimi publik në dokumentin përfundimtar të Tavanëve Buxhetore 2026-2028 si dhe në PBA 2026-2028 të rishikuar. 5. Diskutimi dhe miratimi i akteve të mësipërme në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit në perputhje me detyrimin ligjor dhe afatet kohore të përcaktuara në të. 6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre. 7. Publikimi i akteve përkatëse në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në rubriken e transparencës së Bashkisë. 8. Njoftimi i administratës për aktin/aktet e miratuar. <p>Monitorimi i zbatimit të tij.</p>
<p>Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme.</p>	<p>Opsionet e mundshme për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit janë:</p> <p>Ndryshime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.</p>
<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve</p>	<p>Sugjerimet janë të mirëpritura deri më datë 07 Korrik 2025, në adresën e email:</p> <p>jona.bojko@hotmail.com</p>
<p>Data e publikimit</p>	<p><i>Datë 17/06/2025</i></p>

SEKRETARE E KËSHILLIT



Kalendar i konsultimit publik

Titulli i Projekt-aktit : Mbledhja e rekomandimeve për Tavanet Përgatitore Buxhetore 2026-2028 dhe për Draftin e parë të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2026 – 2028.

Propozuesi : *Bashkia Pogradec.*

Sqarime për projekt-aktin : *Duke qënë se është parqiuur Projekt-Vendimi me titull: Mbledhja e rekomandimeve për Tavanet Përgatitore Buxhetore 2026-2028 dhe për Draftin e parë të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2026 – 2028, në mbështetje të plotë të neneve 18, pika 1), 54 e Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” si dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Pogradec për “Konsultimin Publik” miratuar me VKB nr. 42, datë 05/03/2020, si dhe Rregullores për ankesat, kërkesat dhe petitionet iniciativat qytetare të Këshillit të Bashkisë Pogradec, miratuar me VKB nr. 67, datë 01/06/2020, Kryesia e Këshillit me vendim nr 13, datë 17/06/2025, vendosi kalimin e kësaj iniciative për konsultim publik me të gjitha grupet e interesit*

Grupet që do të konsultohen: *Takim me të gjithë banorët e Bashkisë Pogradec*

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Menyra	Forma
1.	<i>Takim me banorët e Bashkisë Pogradec</i>	07.07.2025	Salla e Këshillit Bashkiak	12:30	<i>Takim publik</i>	Diskutime.

Kryetar i Komisionit: Celnik Haxhillari

Sekretare e Këshillit: Jona Bojko.

